Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

| | |
|---|---|
| **AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I KOSOVËS** | **DIREKTIVË E SIGURISË** |
| Republika e Kosovës<br>Republika Kosovo - Republic of Kosovo<br>CAA<br>Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës<br>Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova<br>Civil Aviation Authority of Kosovo | Nr. i DS-së/Nr. i Lëshimit **01/2026**<br>Data: **18 Mars 2026** |
| LIGJI NR. 03/L-051 PËR AVIACIONIN CIVIL, *I NDRYSHUAR*<br><br>RREGULLORET E NATO-S PËR MJETET AJRORE QË OPEROJNË SI TRAFIK AJROR I PËRGJITHSHËM NË RAJONIN E BALLKANIT (VERSIONI 5.0), *I NDRYSHUAR* | |
| Identifikimi i Sistemit/Shërbimit Funksional të Prekur | FEDERATA AERONAUTIKE E KOSOVËS |
| | |
| Titulli i Direktivës së Sigurisë | Aktivitetet e Paragllajdizmit |
| | |
| Gjendja e Pasigurt e Identifikuar | Aktivitete të paautorizuara me paragllajderë mbi bazat ushtarake, të raportuara në AAC-në e Kosovës |
| Veprimi(et) e kërkuara, arsyetimi i tyre dhe afati(et) i përputhshmërisë | Të gjitha aktivitetet e paragllajdizmit mund të kryhen vetëm brenda zonave të paragllajdizmit të aprovuara operacionalisht, të publikuara në Publikimin e Informacioneve Aeronautike (AIP) të Republikës së Kosovës.<br><br>Kërkesat për aktivitetet e paragllajdizmit duhet të dorëzohen jo më pak se 3 ditë pune para aktiviteteve. Këto kërkesa duhet t'i dorëzohen AIS-it, i cili do t'i ndajë informacionet me AAC-në dhe KFOR-in, për aprovim.<br><br>Në raste të ngjarjeve të veçanta, aktivitetet e paragllajdizmit të planifikuara të zhvillohen jashtë zonave të aprovuara të paragllajdizmit, duhet t'i nënshtrohen autorizimit paraprak nga KFOR-i dhe AAC-ja dhe njoftimet pasuese duhet t'u dërgohen autoriteteve relevante |

| | |
|---|---|
| | (Policisë së Kosovës dhe KANS-it). Kërkesa për operacione të tilla duhet të dorëzohet të paktën pesë (5) ditë pune para aktivitetit.<br><br>Çdo person për të cilin vërtetohet se ka shkelur dispozitat e kësaj Direktive të Sigurisë, do të ndëshkohet në përputhje me Nenet 96 dhe/ose 97 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ndryshuar. |
| Data e hyrjes në fuqi të DS-së | 18 Mars 2026 |
| Aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së | Arianit Islami, U.D. Drejtor i Përgjithshëm |
| Shpërndarë te | Federata Aeronautike e Kosovës (FAK)<br>Shërbimi i Informacioneve Aeronautike (AIS)<br>Forca e NATO-s në Kosovë (KFOR)<br>Policia e Kosovës (PK) |
| Vërejtje | Kjo Direktivë e Sigurisë do të zbatohet që nga dita e nënshkrimit.<br><br>Federata Aeronautike e Kosovës (FAK) është e detyruar të informojë të gjithë përdoruesit e paragllajdizmit për këtë Direktivë të Sigurisë. |